



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2020

Për mbledhjen Nr. 46, datë 26.11.2020, ora 12:00
Të Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 26.11.2020, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 46 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1- Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k, nr 310, seria F11/FK15, miratuar me vendimin e bordit nr. 5, data 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015

2- Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k, nr 309, seria T11/T15, ne veprimtarine e tregimit të energjise elektrike, miratuar me vendimin e bordit te komisionereve nr. 6, date 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015

3- Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të pajtueshmërisë së OSSH sh.a

4- Mbi miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri – Mali i Zi dhe Shqipëri – Kosovë

5- Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregimit të energjisë eletrike, dhënë shoqërisë “Nordic Invest Group” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.07.2016

6- Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI